



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**  
**Kabineti i Ministrit**  
**Kabinet Ministra**  
**Minister's Office**

Nr.63/2022

Datë: 19.05.2022

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 ( paragrafi 1.4 ) nenin 14 ( paragrafi 1 nen paragrafi 1,8 ) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të nenet 11 dhe 32 të Ligjit Nr.04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/24 për Sport, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2015 për Themelimin dhe Licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Nuk i vazhdohet vlefshmëria e licencës së Federatës së Notit të Kosovës.
2. Deri në një vendim tjetër, sportistët e këtij sporti do të jenë në mbikëqyrjen e Komitetit Olimpik të Kosovës;
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Departamenti i Sportit i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport i cili e ka ndryshuar nenin 25 të ligjit bazik. Në paragrafin 25.1 përcaktohet se në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës, si trup i pavarur për arbitrim në sport dhe zgjidhjen e kontesteve lidhur me sportin, funksionon Këshilli i Arbitrazhës Sportive dhe Gjykata e Arbitrazhës Sportive. Paragrafi 25.2 parasheh që Këshilli i Arbitrazhës Sportive vendos për kërkesën dhe shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimeve të federatave sportive, të shoqatave sportive, të klubeve kundër të cilave janë shtjerrur ose nuk ekzistojnë mjete tjera të mbrojtjes juridike. Paragrafi 25.3 parasheh që Këshilli i Arbitrazhës Sportive kryen mbikëqyrjen e përgjithshme të punës së Gjykatës së Arbitrazhës Sportive dhe jep mendime juridike në kërkesat e Komitetit Olimpik të Kosovës ose me propozim të federatave sportive të Kosovës, klubeve dhe shoqatave sportive, ndërsa paragrafi 25.4 përcakton se Gjykata e Arbitrazhit Sportiv vendos lidhur me kërken e palëve të cilat janë pajtuar me kompetencën e kësaj gjykate në kontestet e krijuara gjatë veprimtarisë sportive, për të drejtat me të cilat disponojnë lirisht, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pranuar vendimin përfundimtar të KAS për çështjen KAS 01/2021 në të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësve dhe obligohet e paditura që të pranoj dhe regjistroj gjashtë (6) klubet e notit si anëtare me të drejta të plota në FNK, menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi.

Njëkohësisht, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pranuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës shkresën: "Letër informuese rreth vendimit për masën sanksionuese suspendim nga BE i KOK ndaj FNK-së" me datë 10.05.2022 përmes së cilës ka njoftuar që Bordi Ekzekutiv i KOK në mbledhjen e mbajtur me datë 05.05.2022 ka vendosur për masën sanksionuese, respektivisht për suspendimin nga anëtarësia e KOK për Federatën e Notit të Kosovës si rrjedhojë e mos implementimit të vendimit të KAS nga Federata e Notit të Kosovës.

Duke marr parasysh se sipas legjislacionit të Sportit në Republikën e Kosovës të cekur më lartë, Këshilli i Arbitrazhës Sportive (KAS) është kompetent për zgjidhjen e kontesteve lidhur me sportin për rastet në të cilat palët janë pajtuar me kompetencën e këtij organi, si dhe konsideruar se mos implementimi i vendimit të KAS nga Federata e Notit të Kosovës paraqet shkelje të legjislacionit të sportit në Republikën e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komitetit Olimpik të Kosovës;
- Federatës së Notit të Kosovës;
- Departamentit të Sportit;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

